

SKEDË INFORMUESE

Thirrjen e hapur për bashkitë për projekte mbi Veprimin Klimatik në kuadër të European Climate Initiative (EUKI)

Iniciativa Evropiane për Klimën (EUKI) është një programi financimi për projekte që mbështesin veprimet për klimën në Evropë, i krijuar nga Ministria Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik (BMWK) në vitin 2017. Ky program ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në kuadër të aktiviteteve që ruajnë dhe mbrojnë Evropën nga ndryshimet klimatike.

Synimi i thirrjes:

Promovimi i veprimeve për klimën përmes bashkëpunimit ndërkufitar në Europë, duke kontribuar në qëllimet e neutralitetit klimatik dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Fushat tematike:

- Lëvizshmëria neutrale ndaj klimës
- Politikat ndaj Klimës
- Heqja e karbonit
- Tranzicioni i Energjisë dhe Ndërtesat neutrale ndaj klimës
- Tranzicioni i Drejtë
- Ekonomia e Qëndrueshme

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Në këtë thirrje pranohen të marrin pjesë entitetet nga **shtetet anëtare të BE-së** dhe **vendet kandidatë në Ballkanin Perëndimor** (Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Montenegro, North Macedonia or Serbia), duke përfshirë:

- organizatat joqeveritare (OJQ)
- autoritetet rajonal ose lokal
- ndërmarrje jofitimprurëse
- universitetet apo institucionet e tjetra arsimore

Vendi i aktiviteteve:

EUKI financon projekte në të gjitha vendet anëtare të BE-së dhe vendet kandidatë (të mundshme) të Ballkanit Perëndimor. Fokusi rajonal është në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, në shtetet baltike dhe në Ballkanin Perëndimor. Të paktën gjysma e fondeve të projektit duhet të shkojnë në vendet e synuara në këto rajone.

EUKI mbështet bashkëpunimin ndërkufitar. Projektet e financuara për klimën duhet të kenë entitete partnere në disa vende evropiane.

Buxheti:

- Financimi për projekt do të jetë mes **120,000 euro** dhe **1 milion euro**.

Si bëhet aplikimi:

Procesi i aplikimit është i organizuar në dy hapa. Fillimisht deri më datë 10 Mars 2025 do të dorëzohet aplikimi me përmbledhje projekti duke shpjeguar sfidat ekzistuese, qëllimet dhe veprimet e nevojshme. Nëse projekti përzgjidhet, aplikanti ftohet të dorëzojë një propozim të plotë brenda 4-6 javësh.

Hapi 1: Paraqitja e përmbledhjes së projektit

Në hapin e parë duhet përfshirë informacioni mbi financimin dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme. Gjeni dokumentet përkatëse më folderin:

- **EUKI Project Outline Development Package 9th Call**

Hapi 2: Paraqitja e projekt-propozimit të plotë

Nëse përmbledhja e projektit tuaj përzgjidhet nga EUKI, ju do të ftoheni të përgatisni një projekt propozim të plotë në Hapin 2. Gjeni dokumentet përkatëse më folderin:

- **Project-Proposal-Development-Package**

Kur është afati i fundit:

- Afati i fundit: 10 Mars 2025 në orën 15:00 CET

Linku i thirrjes:

https://www.euki.de/en/project-funding/#headline_2-10-03-2025-deadline-for-submission-of-project-outlines

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose ndihmë shtesë mbi këtë thirrje, na njoftoni!